



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 23 .01. 2026

VENDIM

Nr. 02 Datë 23 /01 /2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHES

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Ejnte , më datë 29.01.2026, **ora 12:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e radhës së Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

- 1. Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
- 2.** Miratimi i Procesverbalit të datës 26.12.2025.
- 3.** Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës
- 4. Projekt – Vendim:** Për miratimin e kriterëve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi I kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike për vitin 2026.
- 5. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin dhjetor 2025.
- 6. Projekt – Vendim:** Ndryshimin e vendimit nr.127 datë 22.12.2025, Për miratimin e Tavanëve Përfundimtare Buxhetore dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (faza III) për vitet 2026-2028 të Bashkisë Pogradec.

- 7. Projekt – Vendim:** “Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe të Buxhetit Vjetor 2027”.
- 8. Projekt – Vendim:** Për një shtesë në VKB NR 128 datë 22.12.2025 “Detajimi dhe miratimi I buxhetit të vitit 2026 të Bashkisë Pogradec”
- 9. Projekt – Vendim:** Miratimin e tarifave të administrimit nga shoqëria Pogradeci Invest Shpk, të ndërtesave ne bashkëpronësi, për vitin 2026.
- 10. Projekt – Vendim:** Miratimin e tarifave të shoqërisë Pogradeci Invest Shpk, për vitin 2026.
- 11. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare familjes Përparim Beshello, fshati Guras, NJ.A Buçimas, Bashkia Pogradec për rënien e zjarrit ne banese e tij.
- 12. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare familjes Xhemile Selko, fshati Piskupat, NJ.A. Hudenisht, Bashkia Pogradec për rënien e zjarrit në banesën e saj.
- 13. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës financiare familjes së z. Agron Lipo, Lagjia 4, Bashkia Pogradec për shkak të rrëshqitjes së banesës së tij.
- 14. Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në VKB nr 145 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Beqir Rusi, familje që ka pësuar dëme në orendi, pajisje dhe te anës ndërtimore si pasojë e përmbytjes ne banesë”.
- 15. Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në VKB nr 144 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Idajet Rusi, familje që ka pësuar dëme në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake dhe në ndërtim si pasojë e përmbytjes”
- 16. Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në VKB nr 148 datë 22.12.2025 të Këshillit Bashkiak “Për dhënien e ndihmës financiare për z. Rudi Tollozhina, familje që ka pësuar dëme në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e përmbytjeve”.
- 17. Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në Vendimin Nr. 85, datë 19.10.2021 “Për miratimin e orareve dhe stacioneve në linjën rrethqytetëse Guras – Pogradec - Guras”.

Ngarkohet Sekretarja e Këshillit , në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale, lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për cdo këshilltar, te kryetari I Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë

paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari I Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

